



RAPORTI GJASHTË MUJOR I PUNËS

JANAR-QERSHOR 2024

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odheljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

XII- Br. 197 MS 03.07.24
RAHOVEC - ORAH

Qershor 2024

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Raport në bazë të punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2022 nga Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë,

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Kërkesat për gjashtë mujorin e parë për vitet 2022-2023-2024

Janar- Qershor	2022	2023	2024
Leje Ndërtimore	26	36	37
Leje Mjedisore	10	22	20
Leje Rrënimi	6	4	5
Kushte Ndërtimore	44	53	47

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2024 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Plani Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç' rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime. Me vendim të kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar dy zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe kushtet e ndërtimit.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

JANAR – QERSHOR 2024					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje ndërtimi	37	28		8	1
Leje rrenimi	5	4		1	
Leje përdorimi	1	1			
Kushte nderimore	47	31	4	12	
Shkrese	62	48	1	13	
Vertetim	39	37	1	1	
Legalizim	7	6		1	
GJITHËSEJ	198	155	6	36	1

Të hyrat e përgjithëshme Janar - Qershor –2024

Parallogaria -Leje ndërtimi	17,902.55 €
Leje përdorimi	20 €
Leje rrenimi	20 €
Vertetim –Pelqim	2,700 €
Legalizim	1,550,24 €
Totali i të hyrave	22,192.79 €

SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të Sektorit të mjedisit leshojmë Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Janar -Qershor 2024					
Nr.total	Aprovuar	Refuzuar	Në shqyrtim	Hudhet	Nr.total
20	15	3	2	0	20

Të hyrat e përgjithëshme në Sektorin e Mjedisit

Leje Mjedisore	1338.54
----------------	---------

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031

Plani Zhvillimor Komunal 2022-2030, është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031, gjatë muajit janarë.

Vlersimi Strategjik Mjedisor VSM për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032

Pas miratimit të Plani Zhvillimor Komunal 2022-2030, janë krijuar mundsit për hapjen e shqyrtimit publik për Vlersimi Strategjik Mjedisor VSM për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032, me datë 22.01.2024 ka përfunduar shqyrtimi publikë, draft Vlersimi Strategjik Mjedisor VSM për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032 është dorëzuar për pëlqim në MMPHI.

Hartën Zonale Komunale 2024-2032

Draft dokumenti i Hartën Zonale Komunale 2024-2032, është pregaditur me marjen e pëlqimit për VSM-ën do dorëzohet në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës për marjen e pëlqimit për shqyrtim publik.

Sistemi i Adresave


Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është angazhuar Stafin Mbështetës për rrjedhat e procesit të Kompletimit të Sistemit të Adresave, detyrë e zyrtarit të angazhuar është harmonizimin emrave të rrugëve në ARIS, ndryshimin e formave të rrugëve (ndarje/bashkim kodesh), kontrollën e hyrjeve sipas metodologjisë së caktuar dhe përgatitjen në statusin “gati për aprovim” për t’i paraqitur në Gjeoportali dhe shfrytëzim nga qytetarët dhe institucionet.

Po vazhdojnë me bartjen e të dhënave në sistem, ku pritët që shumë shpejt të fillojë puna në terren për vendosjen e numrit të hyrjeve.

Ndërtimi i Sheshit Qëndror në Qytet

Sheshi Qëndror është projekt më i madhë që është realizuar ndonjëher në Komunën e Rahovecit. Përmes këtij projekti, synojmë që të kemi qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, e në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu, synohet edhe krijimi i mundësive të reja për biznes dhe rritja e cilësisë së jetës urbane.

Punimet në Sheshin Qendror gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, kanë vazhduar me dinamik sipas planit të menaxhimit, gjatë kësaj periudhe ka përfunduar edhe pjesa e dytë e parkingut nëntoksorë, po ashtu ka përfunduar edhe ndërtimi i vrazhdë I objektit brenda sheshit. Gjatë kësaj periudhe janë shpronsuar edhe pronat nga AKP-ë, ka filluar rrënimi i tyre, në pjesën e stadiumit po vazhdon mbushja.



Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit, ku përfshihen ndërtimi I parqeve në fshatrat: Kramovik, Guri i Kuq, Brestoc, Xërxë, Pataqan i Epërm, Çifllak, Krushë e Madhe, Ratkoc, Drenoc, Opterushë dhe Reti e Poshtme kanë përfunduar.
- Sheshi Republika punimet kanë përfunduar.
- Rregullimi I shtratit të përroit në Krushë të Madhe, është nënshkruar kontratë e re.
- Rregullimi I shtratit të përroit në Malësi të Vogël po vazhdon ndërtimi i Aksit 2.
- Rregullimi i shtratit të përroit në Polluzhë, ka përfunduar 80% e punimeve në rregullimin e përroit, ndërtimi i urës dhe trotuarit për këmbësor.